



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-1994/19
Kaçanik, 29.01.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 29 Janar 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Ylber Bajra; drejtori i drejtive komunale: Zahir Doda, Fatmir Loku, Festim Neziraj, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku dhe Diana Reka; ndërkaq nga zyrtarët ishin : Hidajete Guri, Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua, Farku Dërmaku.

Nga KKZ, në mbledhje mori pjesë, Artan Mezraja.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje e konstatoj kuorumin, pjesëmarrës janë të gjithë anëtarët e KK, ndërkaq në vazhdim e hapi mbledhjen e I (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2019, data 29 Janar me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2019;
3. Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2018;
4. Informatë e Punës së Zyrës së Personelit, për periudhën, Janar-Dhjetor 2018;
5. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

6. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale 00144-51 Zona Kadastrale Kaçanik, në Dushkajë, me kulturë Mal i klasës së 1 (Parë) në emër të Xhabir Zharkut;
7. Informatë lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, për vitin 2018;
8. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2018/2019 ; dhe
9. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfytëzim të pronave të paluajtshme të komunës.

Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së 12 të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me vërejtjen e z. Ekrem Kyçyku, ashtu që Procesverbali të plotësohet me diskutimin e tij, që “drutë e konfiskuara t’iu ndahen familjeve skamnore”. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 12 (Dymbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 27 Dhjetor 2018 / Lënda: 01Nr. 60/03-40308/2018.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku

1. Kërkoj t’iu bëhet Kërkesë ministrive përkatëse për mbrojtjen e pyjeve të Komunës së Kaçanikut, e në veçanti pjesës së Parkut Kombëtar, sepse si duket dëmtimi i pyjeve po merr përmasa shumë të mëdha ? (Kërkesë kjo e ngritur edhe më herët nga po i njëjti anëtar).
2. Po e ngriti një shqetësim në emër të banorëve të lagjeve, ”Tefik Raka” dhe ”Mejdi Dalloshi” lidhur më vërshimet e përroit në atë pjesë. Kjo çështje duhet gjetur mundësi për me rregulluar, sepse vërvimi i përroit shkakton probleme të mëdha për qytetarët e atyre lagjeve e në veçanti të disa shtëpive të atyre lagjeve.

z. Bekim Koxha, Në emër të banorëve të f. Koxhaj- pronarë të pronave të uzurpuara në vitin 1963, kërkojnë të shqyrtohet çështja e pronave në atë pjesë nga Kuvendi, ashtu që përmes drejtorisë përkatëse të ngritet kjo çështje në nivel qendror, në mënyrë që pronat e uzurpuara t’iu kthehen pronarëve të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj të ngriten vetëm kërkesa që bien në kompetenca të organeve të komunës. Ne e dimë se Kuvendi i Komunës ka marrë një vendim për çështjen e pronave të cilat i potencoju z. Bekim Koxha, mirëpo ato vendime të KK nuk janë zbatuar asnjëherë.

znj. Kaltrina Tafili, Me intereson të di, çështja e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara. për të cilën është formuar Paneli përgjedhës, përse nuk po shpallet Konkursi, kur do të bëhet përgjedhja e anëtarëve të këtij komiteti ?

Kryesuesi i Kuvendit, Për çështjen të cilën e ngriti znj. Kaltrina Tafili, unë shumë shpejt kam me marrë veprime të nevojshme për me thirrur Panelin përgjedhës dhe ka me u shpallë Konkursi.

z. Adnan Reka,

1. Kërkojmë që rrugët e Komunës së Kaçanikut të pastrohen më mirë gjatë reshjeve të borës, sepse krahasuar me Komunat tjera, Komuna jonë është në gjendje mjaft të keqe.

2. Kam një informacion të pa konfirmuar se ndriçimi publik në bulevardin "Ismail Raka" do të zëvendësohet nga një lloj tjetër i ndriçim publik, ndërsa dihet se ky ndreqim ka një kohë të shkurtë që është ndërruar dhe ka plotësuar edhe kriterin e energjisë efecientë, a është e vërtetë dhe për çfarë ndriçimi publik bëhet fjalë?

3. Ka kohë që nxënësit e shkollës në Kovaçec nuk kanë ujë të pijshëm në shkollë. Me ndërtimin e autostradës rezervuari i ujit që furnizon shkollën me ujë të pijshëm për 180 nxënës ka mbetur nën nivelin e rrugës, dhe si pasojë të gjitha ujerat atmosferik dhe vajrat që kullohen nga rruga automobilistike derdhen dhe kullohen në këtë rezervuar. Ka më shumë se 7-8 muaj që kemi bërë vërejtje për një gjë të tillë, pas ekzaminimit inspektori sanitare komunal kishte konstatuar se ujë në atë gjendje nuk ishte i pijshëm, por asgjë nuk është ndërmarrë. Prandaj, edhe njëherë kërkojmë të merren masa urgjente sepse pasojet mund të jenë të mëdha.

z. Ekrem Raka, Më intereson të di, ku kanë ngelur procedurat për themelimin e Teatrit të qytetit të Kaçanikut ?

z. Shpend Krusha, Në emër të qytetarëve të f. Gabriticë e kam një shqetësim se nuk po pastrohet bora në atë fshat, ndërkaq në fshatin tjetër në Duraj, fshat ky i ngjitur me f. Gabriticë,, rrugët po pastrohen nga kompania e kontraktuar për pastrimin e rrugëve lokale. Pyetja është, Ku qëndron arsyja që nuk bëhet pastrimi i borës në rrugën e f. Gabriticë ?

znj. Lirije Luta, Kam një kërkesë nga disa gra të Komunës së Kaçanikut, që t'iu lejohet zhvillimi i mësimit jo formal në shkollat e mesme të komunës dhe t'iu krijohen lehtësira në pagesa për regjistrimin e viitit shkollor ? Këtë kërkesë e kanë bërë edhe në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, atëherë konstatoj me kaluar në pikën e radhës, ndërkaq përgjigjet në Kërkesa do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës. Në vazhdim kalojmë në pikën vijuese:

2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky është një Plan që e bënë Kryetari i Komunës me Drejtore të Komunale.. Plani është bukur voluminoz, për sqarime të nevojshme, nëse kërkohet, prezantë është Kryetari i Komunës, Besim Ilazi. Nëse ka të interesuar me marrë fjalën në këtë pikë, e hapi diskutimin;

z. Ekrem Kyçyku, Plani është shumë voluminoz, ndërkaq në këtë plan shihet se më tepër janë përshkruar punët dhe detyrat e punëve të shërbimeve, sesa është bërë një plan i mirëfilltë. Përve Zyrës për Barazi Gjinore dhe DAK që janë përcaktuar më në detaje punët të cilat kanë më u kryer, por edhe të këto shërbime nuk janë përcaktuar mjetet buxhetore për realizimin e objektivave, ndërkaq të shërbimet tjera nuk janë caktuar afatet kohore për realizimin e objektivave. Të DSHPE dhe të DBPZHR janë përcaktuar aktivitetet dhe afatet kohore për realizimin e tyre, por shumica e aktiviteteve të përcaktuara nuk e kanë koston e përcaktuar. Duke u nisur nga ajo se ky plan pune është më tepër përshkrues e jo i detajuar, konfirmoj se subjekti politik i LVV nuk do të votojmë këtë Plani pune.

z. Selim Reka, Në këtë Plan pune shihet se mungon kostoja buxhetore për të gjitha aktivitetet e parapara për realizim në vitin 2019.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk pati, kështu këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 15 votë Për, 5 votë Kundër, Abstenuan 7 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2019.

3. Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Nga Raporti shihet se KKSBB ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje për gjatë vitit 2018, ndërkaq disa nga rekomandimet që dalin nga ky raport, si; angazhimin më të madh të inspektorëve sanitar, pastaj, të pengohet prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe disa tema të tjera, kujtoj së nuk janë në kompetencia të KKSBB. Ky këshill ka pasur tema me të rëndësishme të cilat është dashur t'i shqyrton. Tjetër, disa rekomandime të potencuara nga KKSBB kanë mbetur në letër, si masat për shfrytëzimin e hapësirave publike, kjo nuk është bërë, pastaj, prerja ilegale e pyjeve, nuk është ndalur, pastaj nuk është zgjidhur çështja e parkingjeve, e kështu me radhë.

z. Shpend Krusha, Unë rekomandoj që KKSBB të merret me sigurinë e përgjithshme të qytetarëve të komunës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, duke i parandaluar dukuritë negative si; ekstremizmin, narkomania, vjedhjet, rrahjet në shkolla e kështu me radhë.

Kryetari i Komunës, Raporti i KKSBB është këshilllëdhënës. Temat të cilat u ngritën që duhet të shqyrtohen nga KKSBB, edhe unë kujtoj se duhet të shqyrtohen. Në KKSBB janë çështjet e përcaktuara që i shqyrton ky këshill, por në mbledhjet e këtij këshilli kemi edhe pikën; Të ndryshme, ku në kuadër të kësaj pike mund mund të debatohen çështje të tjera të cilat i adresohen këtij këshilli. Të çështjet të cilat u ngritën, keni të drejtë, dhe këto çështje mund të ngritën përmes OJQ-ve, Policisë së Kosovës etj. Temat e lira është e drejtë e secilit me i ngritur dhe me u propozuar të shqyrtohen nga organi.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kjo Informatë ishte sa për njostimin tuaj, kështu që konstatoj së,

Kuvendi i Komunës përmes kësaj Informate, u Njoftua me Aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për gjatë vitit 2018.

4. Informatë e Punës së Zyrës së Personelit, për perudhën, Janar-Dhjetor 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Pjesa e përsonelit është ndarë nga raporti i Zyrës së Kryetarit të Komunës, për shkak të përfomancës që po kërkohet për përfitim të grantit.Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Unë përmes këtij raporti kuptova se Komuna jonë ka 22 punëtorë me kontratë mbi vepër (për shërbime të veçanta) që do të thotë se kontrata mbi vepër është paraparë për ekspertë të fushave të caktuar, e jo për punësime në bazë të preferencave politike, kur dihet se Komuna e Kaçanikut prin për administratën më të ngarkuar në regjion.

z. Shpend Krusha, Më intereson të di z. Kryetar, sa vende të lira janë në Shërbimin Civil të Komunës ? Nëse ka vende të lira të punës, atëherë pse nuk shpallen ato vende të lira të punës edhe në rrjetet sociale si është Facebook?, kur dihet se ky rrjet social po ka qasje më të madhe dhe për një transparencë me të madhe.

Kryetari i Komunës, Të Kontratat në vepër, jemi komuna që me së paku kemi punëtorë me kontratë në vepër. Nëse e marrim Prishtinën, Prishtina i ka 400 apo 500 punëtorë me kontratë në vepër, ndërkaq ju si subjekt politik i LVV, nuk i keni bërë trysni asaj komune pse ka aq shumë punësime më kontrata të tillë. Të konkurset, vendet e lira të punës hapen aty ku drejtoria e parashevë të arsyeshme. Numri i lirë i vendeve të punës ndryshon, varësisht nga numri i atyre të cilët dalin në pension, ndërkaq nuk e shoh të arsyeshme që të publikohen vendet e lira të punës, sepse çdo vend i lirë i punës ka procedura paraprake.

z. Shpend Krusha, Vendet e lira duhet të publikohen Kryetar, kjo është formë demokratike e transparencës për qytetarët e komunës.

Kryetari i Komunës, Për vendet e lira të punës iu njoftoj se ka procedura, bëhet kërkesa, dërgohet në ministri, shpallet konkursi, dërgohet në ministri, pastaj nëse e aprovon ministria, shpallet vendi i lirë i punës dhe i njëjtë publikohet në Gazetë dhe në Faqen zyrtare të komunës. Gjithashtu bëhen publike në faqën zyrtare të komunës edhe kandidatët që pranojnë. Të çështja e numrit të vendeve të lira, të punës, unë nuk e di sa është numri i saktë, sepse numri varion me faktin se disa dalin në pension e kështu me radhë, ndërkaq nuk e di sa është e arsyeshme me e publikuar numrin e vendeve të lira të punës. Nëse e sheh të arsyeshme z. Krusha, mundesh me iu drejtuar Zyrës së Personelit më Kërkesë dhe besoj se t'i jepin të dhënat për numrin e vendeve të punës të lira të punës në Shërbimin Civil.

z. Shpend Krusha, Në momentin që lirohet z. Kryetar një vend i lirë i punës, atëherë komuna është e obliguar që menjëherë me marrë veprime të nevojshme për zhvillimin e procedurave për plotësimin e atij vendi të lirë të punës, ashtu që me e shpallë Konkursin. Komuna nuk ka nevojë më pritur e mos me i plotësuar vendet e punës të cilat lirohen.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë, konstatoj se,

Kuvendi i Komunës u Informua me Aktivitetin e Zyrës së Përsonelit në vitin 2018, përmes materialit të Informatës së ofruar nga kjo zyrë.

5. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo çështje është shqyrtuar edhe në mbledhjen e KPF, ndërkaq me Kërkesën e KPF kemi pasur një takim me Shefat e GP dhe BI. Duke u nisur nga çëndrimi I BI, kemi ardhur në përfundim që shërbimi për hapjen e varrit të mbetet me u diskutuar në të ardhmën. Propozim Vendimit i janë shtuar dy sherbime: bartja e kufomes dhe ruajtja e kufomës. Në propozim vendim duhet të futet edhe një nen, ku përcaktohet që, qytetarët mos tē lirohen nga anëtarësia në saje të shërbimeve që i financon komuna, ndërkaq edhe një pasues, ku theksohet se BI, nuk mundet me detyruar familjen me paguar anëtarësinë e mos me ia kryer sherbimet në rastin e vdekjes së anëtarit të familjes. Sa i përket shërbimit për transportin e kufomës, ky shërbim do të bëhet në tërë teritorin e Republikës së Kosovës, qoftë nga spitali, aeroporti i Prishtinës e deri në shtëpi, e kështu me radhë.

z. Ramadush Osmani, Pagesat bëhen nga pozicioni i Mallrave dhe Sherbimeve. Ruajtja e kufomes në friz, bëhet brenda çmimit 175€ për të gjitha shërbimet.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet që u dhanë në këtë Propozim Vendim, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Edhe pse ishte Kërkesë për ridizajnimin e vendimit për kompensimin e shpenzimeve të varrimit, ne në takimin të cilin e patëm me ata të BI, pozitive është se është arritur të paguhen edhe disa shërbime, si; si piramida, transporti, ruajtja e kufomes si dhe heqja e kushtëzimeve që u potencua nga Kryesuesi i KK. Ne në takimin që patëm pak me herët me BI, kemi marrë zotim nga DSHPE dhe BI, që në të ardhmën të zbritën çmimet dhe të hyjnë edhe shërbime tjera, siç është shërbimi për hapjen e varrit. Të varrezat, është mirë në të ardhmën të ndërtohet një barakë, për me i vendosur mjetet e punës.

z. Ekrem Kyçiku, Unë propozoj që në shërbime të varrimit të futet edhe; hapja e varrit. Tjetër, të specifikohen shuma e mjeteve buxhetore për secilin nga shërbimet e varrimit, ndërkaq kujtoj se shuma 175€ është e mjaftueshme për të gjitha shërbimet e varrimit, përfshirë edhe hapjen e varrit. Unë kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës që edhe një herë të debatohet me BI, çështja e shërbimi për hapjen e varrit.

z. Bekim Koxha, Në të ardhmën, kur të diskutohet kjo çështje, të hyn edhe rregullimi i varrezave, sepse varrezat janë në gjendje të vështirë e sidomos në f. Doganaj. Me pasur me ndarë një fond për mirëmbajtjen e varrezave, do të është shumë mirë, sepse gjendja lokacioneve të varrezave është shumë e rëndë, janë mbushur varrezat me therajanë pa rrethoja e kështu me rradhë.

z. Ekrem Raka, Kosova është shtet laik me shumë etnitete dhe mbi bazën e kësaj unë kujtoj se forma e lejimit mjete buxhetore në këtë formë si janë proozuar BI, nuk është e qëlluar, kur dihet fakti se mund të kemi raste të vdekjeve edhe nga komunitetet tjera. Unë jam me u lejuar mjetet për destinimin e përcaktuar si në Propozim Vendim, ndërkaq shërbimet me u kryer nga kompania e licencuar e jo nga BI. Kompania që e merr punën në bazë të tenderit,

mundet pastaj me nënkontraktuar punën me BI, për ato shërbime të cilat i kryen kjo bashkësi.

Kryesuesi i Kuvendit, Në të ardhmën procedura e kryerjes së punimeve edhe për këto shërbime ka me u bërë përmes tenderimit, formë kjo e cila ka me qenë e detyrueshme, aty lind edhe konkurenca në mes kompanive, ndërkaq edhe niveli i shërbimeve edhe shërbimi i hapjes së varrit në të ardhmën ka hyrë, duke u planifikuar edhe buxheti i komunës. Për BI shërbimi për hapjen e varrit për momentin është jo i ekzekutueshëm, gjithashtu edhe i kushtueshëm edhe për buxhetin e komunës, kështu e prolonguam për një periudhë jo të gjatë këtë shërbim. Vlera e kompensimit të shërbimeve nuk është e madhe nëse i krahasojmë me komunat tjera, shërbimet po kryhen gati të gjitha, përpos hapjes së varrit.

Kjo formë e pagesës së shpenzimeve të varrimit është duke funksionuar tani për tani kështu në terë Kosovën, por në të ardhmën do të ndryshohet, sepse edhe pse komuna jonë pothuajse nuk ka etnitete, ka komuna që gati janë përgjysmë me komunitete, kështu që forma e procedurës përmes prokurimit ka me qenë obligative në të ardhmën, kështu në të ardhmën do të diskutohet edhe kjo çështje, sepse dita ditës është duke u bërë me problematike.

z. Ekrem Kyçiku, Kërkoj 5 minuta pushim për konsultim. Kjo Kërkesë e z. Kyçiku u aprovua, ashtuqë pas 5 minutave, anëarët e KK u kthyen në sallë.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë vazhdojmë me diskutimin e kësaj pike aty ku mbetëm:

z. Ekrem Kyçiku, Në propozim Vendim si po shihet, nuk janë futur shërbimet të cilat janë shtuar, pastaj nuk janë specifikuar shumat për secilin shërbim, kështu që duke u nisur nga kjo, ne subjekti politik i LVV konfirmojmë se do të abstenojmë kur kjo pikë të dal në votim për aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë po iu njoftoj se në takimin të cilin e patëm më herët me BI, u vendos që këtij Propozim Vendimi, të transporti i kufomës, t'i shtohet “në tërë territorin e Republikës së Kosovës” nga aeroporti i Prishtinë, Spitali etj. deri në vendin ku varroset kufoma, pastaj, të shtohet një nen ku përcaktohet se ky Vendim nuk nuk i liron qytetarët e komunës nga pagesa e antarësisë. Gjithashtu të shënohet se BI nuk mund të i obligoj qytetarët e komunës që nuk e kanë kryer anëtarësinë, mos t'i u kryej shërbimet e varrimit. Në marrëveshje të hynë edhe çështja e ruajtjes së kufomës në morg, i cili shërbim është në kuadër të këtij çmimi. Atëherë, Propozim Vendimin me këto ndryshime e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 21 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 6 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore (për çdo rast nga 175€) të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

6. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale 00144-51 Zona Kadastrale Kaçanik, në Dushkajë, me kulturë Mal i klasës së 1 (Parë) në emër të Xhabir Zharkut.

Kryesuesi i Kuvendit, Këtu është fjala për marrjen e Vendimit Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Praktika të tillë kemi pasur edhe më herët, merret vendimi nga KK, pastaj dërgohet në MBPZHR, kjo ministri e shqyrton vendimin dhe nëse e sheh të

arsyeshme e lëshon një Pëlqimin dhe në bazë të atij Pëlqimi merret Vendimi Përfundimtar nga Kuvendi i Komunës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Ashtu siç kemi thënë edhe me herët se këto Propozim Vendime për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore, përkatësisht si tokë pyjore e klasës 1 - 4, janë në kundërshtim me Ligjin 02/L-26 për Tokën Bujqësore, paragrafin 10.5 si dhe UA 41/2006 nenit 6 paragrafi 6.2, të cilit ju i referoheni: 10.5. Në planet hapësinore sipas vlerës së shfrytëzimit dhe bonitetit të saj toka bujqësore përcaktohet: a) klasa e 1 - 4 përcaktohet vetëm si tokë bujqësore, përkatësisht si tokë pyjore; b) klasa e 5 dhe 6 përcaktohet si tokë bujqësore, pyjore dhe përjashtimisht si tokë për qëllime të tjera; c) klasa 7 dhe 8 përcaktohet si tokë bujqësore e cila sipas nevojës shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera. 6.2 Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 1 deri 4 do të bëhet me vendimin e Kuvendit Komunal pas marrjes së pëlqimit nga Ministria. Unë dua të ri konfirmoj keqardhjen time se si në vazhdimësi po keqpërdoret Kuvendi duke shtyrë që të marrë vendime të padrejta dhe kundërligjore.

z. Ukshin Qallaku, Ka shumë Vendime Paraprake të cilat i ka marrë Kuvendi i Komunës, ndërkaq Ministria (MBPZHR) nuk na ka sjellë asnjeherë ndonjë dokument për procedurë të mëtutjeshme. Unë e kam dërguar paraprakisht këtë lëndë në MBPZHR, ndërkaq ata me kanë sugjeruar që njëherë të merret Vendimi Parraprak nga Kuvendi i Komunës për atë parcelë, sepse e kemi me PZHKG, pastaj ministria e lëshon Pëlqimin në bazë të Vendimit të cilin do ta marr Kuvendi i Komunës, kjo është arsyja që e kam adresuar këtë çshtje në KK. E keqja e kësaj është se përkundër faktit se ne i dërgojmë në ministri lëndët, nuk na kthehet ndonjë përgjigje. Ka lëndë që e kam dërguar që 17 muaj, ndërkaq ende nuk kemi ndonjë përgjigje. Ne, fillimisht po duhet me marrë një vendim paraprak, në mënyrë që me u pajtua me i bërë këto ndryshime, pastaj në bazë të atij vendimi të na jep Pëlqimin ministria (MBPZHR) në mënyrë që pastaj me vendosur KK me i bërë ato ndryshime në bazë të atij pëlqimi.

z. Ekrem Kyçyku, Çështja është se Propozim Vendimi i drejtorisë është thirrur në dispozita të gabueshme. Në propozim vendim bëhet fjalë për pronë të klasit të 1, ndërkaq nëse i analizojmë dispozitat ligjore ku është thirrur DUKMM, shihet së është thirrur në dispozita ligjore të cilat e që e rregullojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të klasën e 5 dhe 6.

z. Ukshin Qallaku, Të dispozitat ligjore janë bërë disa gabime teknike, të cilat gabime nuk e di nëse janë përmirësuar.

z. Bekim Koxha, Të parcela e propozuar, është cituar një dispozitë që bjen në kundërshtim me ligjin. Është mirë kur të kemi çështje të kësaj natyre, të shqyrtohen dhe analizohen mirë ligjet nga drejtoria përkatëse (DUKMM), sepse ne nuk po i njohim dhe kuptojmë sa duhet ligjet, kështu në këtë drejtim po biem në pozitë të vështirë se nuk po e njohim ligjin.

z. Ukshin Qallaku, Me 17 Maj është marrë një Vendim i komunës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe i njëjtë është dërguar në ministri (MBPZHR), ndërkaq iu njoftoj se nga ajo datë, ende nuk kemi ndonjë përgjigje nga kjo ministri. Për kundër asaj se, nuk po marrim përgjigje nga ministria në njerën anë, ndërkaq në anën tjetër unë kujtoj se ne si komunë duhet me iu bërë zgjidhje qytetarëve të komunës lidhur me ndërrimet e destinimit të tokave bujqësore. Të ky Propozim Vendim, sipas PZHKG në fuqi, parashihet tokë

bujqësore dhe digitalizim i vendbanimeve 2004 dhe zona urbane, d.m.th.duhet të kemi të qartë se është fjala për një territor ku ka vendbanim.

z. Selim Reka, Unë mendoj se ka mundësi me pritur në çështjen e ndërrimit të destinimit, të tokave bujqësore deri me miratimin e Planit të ri zhvillimor të komunës, pasi janë marrë iniciativa për hartimin e Planit të ri Zhvillimor të Komunës. Duke u nisur nga fakti së PZHK është në procedurë të hartimit të tij, në emër të subjektit politik të LDK-së, konfirmoj së nuk do ta votojmë këtë Propozim Vendim, për arsyet të cilat i potencova.

Kryesuesi i Kuvendit, Duhet ta kemi të qartë çështjen së, ky Propozim Vendim është Paraprak, ndërkaq ka edhe procedura të tjera pas këtij vendimi, si çështja e marrjes së Pëlqimit nga MBPZHR dhe miratimi final i vendimit nga KK. Kuvendi i Komunës nuk mundet me bërë ndërrim destinimi të klasës 1-4 pa e marrë Pëlqimin pala nga Ministria. Nese ministria nuk jep Pëlqimin, ua bëjë me dije së lënda nuk vjen më në Kuvendin e Komunës. Ne duhet ta kemi të qartë se çka është Vendimi Paraprak dhe çka është Vendimi Përfundimtar. Me këtë vendim nuk bëhetndërrimi i destinimit të pronës në fjalë, por happen rrugët për procedura të mëtutjeshme.

z. Ukshin Qallaku, Ministria ka komision ad hoc që del e shqyrton çështjen dhe ai komision e vlerëson. Nëse komisioni nga Ministria e BPZHR nuk e lejon atë ndërrim destinimi, atëherë lënda nuk vjen më në Kuvendin e Komunës. .

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çshtje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 17 votë Për, Kundër ishin 10 anëtarë, Abstenime nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale 00144-51 Zona Kadastrale Kaçanik, në Dushkajë, me kulturë Mal i klasës së 1 (Parë) në emër të Xhabir Zharkut.

7. Informatë lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, për vitin 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se,

Kuvendi i Komunës u, Njoftu me aktivitetin e Komunësë Kaçanikut në zbatim të Planit të integritetit për vitin 2018, sipas Informatës të cilën na e ka adresuar DAP.

8. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2018/2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe për këtë pikë materialin e keni marrë, prezentë në mbledhje është drejtori i DAK, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Informata është reale, shqetësimi është se ka një rënie të lehtë të numrit të nxënësve, suksesi është pak i fryer në shkollat fillore, kjo po vërehet kur po vijnë nxënësit në shkolla të mesme, ku nxënësit nga suksesi i shkëlqyer po bijnë në suksese me të ulëtë.

Mendoj se në këtë drejtim personeli arsimor duhet me qenë ma dorështrenguar në nota, përfshirë edhe të ata të shkollave të mesme. Të mungesat, është një rënje e vogël e mungesave, si të nxënësit ashtu edhe të arsimtarët, por duhet bërë ende në këtë drejtim për një rezultat edhe me të kënaqshëm. Numër të orëve të humbura ka më tepër në SHF “Qamil Ilazi”, të Gjimnazi dhe të SHMP, mirëpo dihet se disa orë që humbin janë të arsyeshme, si fjalë vjen për shkak të trajnimeve të mësimdhënësve, sëmundjeve e kështu me radhë.

znj. Nazife Krasniqi, Nga vet informata, e kuptojmë se është paraqitur një pasqyrë e reale e gjendjes së shkollave të komunës, ndërkaq është shqetësuese rënje e lehtë që e potencoj edhe z. Selim Reka në të dy shkollat e mesme, ashtu që regjistrimi i nxënësve nuk është në harmoni me planifikimin. Me intereson të di pse kanë mbetur një numër i madh i nxënsëve pa regjistruar si në këto dy shkolla, ndërkaq nga të dhënat shihet se ka rënje të lehta edhe në disa shkolla fillore të numrit të nxënësve. Kjo të bënë me kërkuar pse ka rënë ky numër i nxënësve në shkolla. Të suksesi i nxënësve, shifrat tregojnë se në SHMP suksesi është shumë i ultë, ndërkaq ka një numër të nxënsëve të panotuar, kjo është shqetësuese, ndërkaq anët pozitive, gjinia femrore shihet se është përparrë në aspektin e suksesit. Nga të dhënat shihet se ka pasur investime nga MASHT, dhe investime të tjera në shkolla, kjo është e mirë për ne, këto investime janë për t'u përshendetur. Të çështja e mjeteve muzikore, është bërë kabineti i muzikës, i cili është për t'u përshendetur, është bërë një klub i muzikës i cili edhe po funksionon. Në f. Runjevë dhe Strazhë, parashihet hapja e paraleleve parashkollore, ndërkaq, kjo është mirë me u realizuar, ndërkaq është keq për ato para:ele shkollore që janë mbyllur. Të çështja ku cekur se disa shkolla kanë kordinator të cilësisë, por nuk është potencuar në cilat shkolla, e që thuhet se i kanë përbushur kriteret, ndërkaq nuk potencohen cilat kriteret duhet me i pasur shkolla me pasur kordinator të cilësisë, ndërkaq me vjen mirë që po funksionon komisioni për persona me aftësi të kufizuara në shkolla.

z. Adnan Reka, Një pyetje për drejtorin e DAK, çfarë ndodhi me disa laptopë dhe projektorë që u përfol se do t'i jepen mësimdhënësve ne shkolla?

z. Bekim Koxha, Të çështja e grevave në arsim, me intereson të di, si do të kompensohen orët e humbura, a ka ndonjë plan për këtë çështje?

z. Ekrem Kyçyku, Është një Informatë e mirë që është bërë, me anë të cilit po njoftohem i përgjendjen e arsimit, ndërkaq me intereson të di, sa janë përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara në mësim të rregullt në shkollat e komunës. Vërejtje imja është së, nuk dihet përforma e arsimtarëve në shkolla e që besoj se vlerësimi i përformancës së mësimdhënësve do të bëhet në të ardhmën. Nga materiali kuptohet se shkollat janë pajisur me kabinete, përshirë edhe atë të muzikës, ndërkaq sa e di unë, nuk ka staf që dinë me bërë ekzekutimin e pajisjeve të këtyre kabinetave.

znj. Lirije Qeli, Duke marrë parasysh faktin së shkolla është institucion i organizuar, në të cilën nxënësit edukohen dhe arsimohen, patjertër të gjithë pjesëmarrësit në procesin edukativ arsimor, duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë të dy komponentëve; edukativ dhe arsimor. Tendencat për reforma në arsim gjithnjë e më tepër e favorizojnë komponentën e arsimit në shkolla, kundrejt komponentit edukativ. Kjo ndodhë sepse, në kurikulat shkollorë lëndët dhe orët mësimore janë në rritje. Angazhimi i arsimtarëve në kryerjen e punëve administrative gjithashtu nga dita në ditë po bëhet më i kërkuar, pse jo edhe i obliguar, kështu që arsimtari i shkollës bashkëkohore që themi se pedagogët, sa shkon e më shumë angazhohet në kryerjen e detyrave ndaj organeve me të larta komponente dhe realizimin e

plan porogrameve (komponentin arsimor) ndërsa gjithnjë e më pak angazhohet në edukimin e brezit të rinjë.

z. Zahir Doda, Gjendja në arsim dihet si është, për shkak të grevës. Të çështja e laptopëve, laptopët kanë ardhur, por jo me parametrat e caktuar, kjo ka qenë kritikë shumë e madhe se nuk kemi munduar me i pranuar ashtu, kështuqë ky proces duhet me u ritendëruar. Të çështja e grevave, nuk ka kush që mund të thotë së nuk kanë të drejtë arsimtarët, kështu për këtë çështje as unë nuk di çka të themi. Të koordinatorët e cilësisë, numri është mbi 250 nxënës për me pasur kordinator të cilësisë. Kjo të bënë me ditur së kordinator të cilësisë kanë vetëm shkollat e mëdha. Të çështja e nxënësve me aftësi të kufizuara, funksionon paralelja e cila paralele deri me tanë ata nxënës i ka bartur komuna, ndërkaq kjo paralele ka me u mbyllur. Edhe ata nxënës me nevoja të veçanta me mësim jashtë komunës, janë transportuar dhe mund të themi së jemi komuna që më së shumti iu kemi dhënë prioritet fëmijëve me nevoja të veçanta. Të çështja që e potencoj Lirije Qeli, iu njoftoj se kriter për këtë vit ka me qenë, pjesa edukative, ku do t'i japim rëndësi me të madhe komponentës edukative në shkolla, këtë e kam diskutuar me drejtoret e shkollave.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diľka tjetër, Informata ishte sa për njoftimin e juaj, atëherë konstatoj së,

Kuvendi i Komunës u Njoftua me Aktivitetin e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2018/2019.

9. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfytëzim të pronave të paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diľka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprova me 22 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 5 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për ndryshim plotësimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, ashtuqë nga ky komision hiqet me kërkesën e tij, anëtari, Zylfi Koxha, ndërkaq në vend të tij për anëtar të komisionit emërohet, Besnik Bajra.

Dička tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:47, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfiqe Malsiu
Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);

**nga Mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2019, mbajtur me 29 Janar 2019.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 22. 02. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: **z. Ekrem Kyçiku**
z. Adnan Reka
z. Shpend Krusha

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 29. 01. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

z.Ekrem Kyçiku,

Po e ngriti një shqetësim në emër të banorëve të lagjeve, "Tefik Raka" dhe "Mejdi Dalloshi" lidhur më vërshimet e përroit në atë pjesë. Kjo çështje duhet gjetur mundësi për me rregulluar, sepse vërvimi i përroit shkakton probleme të mëdha për qytetarët e atyre lagjeve e në veçanti të disa shtëpive të atyre lagjeve.

➤ *Përrroi i lagjeve "Tefik Raka" dhe "Mejdi Dalloshi" është i evidentuar nga sektori i Emergjencave në kuadër të DSHPE-së, me rrezikshmëri të kufizuar, si me prioritet për rregullimin e shtretërve të tyre. Ashtu siç edhe e kam potencuar edhe në përgjigen e pyetjeve së seancës së kaluar, planifikimet e investimeve kapitale për vitin e ardhshëm do t'i orientojmë në rregullimin e shtretërve të përrrockave shkaku i konfiguracionit të terenit në komunën tonë dhe rrezikshmërisë së vazhdueshme të tyre.*

z. Adnan Reka,

Kërkojmë që rrugët e Komunës së Kaçanikut të pastrohen më mirë gjatë reshjeve të borës, sepse krahasuar me Komunat tjera, Komuna jonë është në gjendje mjaft të keqe.


➤ *Kompania e angazhuar për mirëmbajtjen dimërore te rrugëve lokale ka intervenuar në vazhdimësi, me kapacitete të plota të makinerisë, në largimin e borës dhe hudhjen e kripës industriale në rrugët lokale duke iu dhënë prioritet zonës urbane dhe rrugëve kryesore të fshatrave të komunës gjatë periudhës sa kemi pasur të reshura të borës dhe ngrica në rrugë. Mund të ketë pasur vonesa shkaku i terenit të komunës sonë por rrugët në përgjithësi kanë qenë të kalueshme.*

2. Kam një informacion të pa konfirmuar se ndriçimi publik në bulevardin "Ismail Raka" do të zëvendësohet nga një lloj tjeter i ndriçim publik, ndërsa dihet se ky ndreqim ka një kohë të shkurtë që është ndërruar dhe ka plotësuar edhe kriterin e energjisë efeciente, a është e vërtetë dhe për çfarë ndriçimi publik bëhet fjalë?

- Në kuadër të projektit “ Ndërrimi dhe rregullimi i trupave ndriçues në rrugët e qytetit ” është bërë ndërrimi i trupave ndriçues të teknologjisë së vjetër me trupa të rinje të tipit LED, ku në këtë projekt është përfshirë edhe bulevardi “Ismajl Raka” që tani ka një ndriçim më të mirë dhe eficient, prandaj aktualisht nuk planifikohet që bëhet ndërrim i sistemit të ndriçimit publik në këtë pjesë.
- z. **Shpend Krusha**, Në emër të qytetarëve të f. Gabriticë e kam një shqetësim se nuk po pastrohet bora në atë fshat, ndërkaq në fshatin tjeter në Duraj, fshat ky i ngjitur me f. Gabriticë, rrugët po pastrohen nga kompania e kontraktuar për pastrimin e rrugëve lokale. Pyetja është, Ku qëndron arsyja që nuk bëhet pastrimi i borës në rrugën e f. Gabriticë ?
- Kompania e angazhuar për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale ka kontratë njëvjeçare për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të komunës sonë. Është intervenuar edhe në këto dy lokalitete, përkatësisht në rrugën “Avdyl Dura”-Duraj dhe rrugën “Hatem Hasaj”-Gabriticë, si segmente kryesore të këtyre dy fshatrave. Kemi pasur ankesa në pastrimin e rrugës “Razim Hasaj”, që është segment rrugor në fshatin Gabriticë, dhe kemi njoftuar kompaninë që të intervenoj edhe në këtë rrugë.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit

PËRGJIGJE

Për anëtarin e Kuvendit Komunal,Z.Bekim Koxha.

Në bazë të kërkesës suaj,e cila na është dërguar me shkresë për sqarimin lidhur me pronat e fshatit Koxhaj,prona të cilat janë marrur nga ish regjimi,ne ju njoftojmë se këto prona menaxhohen nga AKP-ja dhe e vtmja mënyrë për zgjidhjen e kësaj çështje është t'i adresoheni zyrës së Gjykatës Speciale në kuadër të AKP-së.Sa i përketë Kuvendit të Komunës dhe Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, ne nuk kemi asnjë kompetencë lidhur me këtë kontest.

Me respekt,
Drejtor i DUKMM-së
Ukshin Callaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

Përgjigje në pyetjen e z. Adnan Reka: Çka keni ndërmarrë për ujin e pijshëm në shkollën e Kovaçecit?

Vitin e kaluar është intervenuar vetëm në pastrimin e rezervuarit. Në vjeshtë dhe gjatë dimrit prap janë futur ujrat atmosferike dhe është ndotur uji i pijshëm. Sipas përgjegjësit të shkollës, nevoitet që rezervuari të betonohet në pjesën e sipërme. Për shkak të temperaturave të ulëta nuk mund të punohet me beton. Në momentin që krijohen kushte për punë do të intervenohet.

Përgjigje në pyetjen e z. Ekrem Raka: Ku kanë arritur procedurat për themelimin e teatrit të qytetit?

Komisioni i formuar nga MKRS për vlerësimin e kushteve për themelim të teatrit, ka rekomanduar disa ndërhyrje renovuese në objektin e Shtëpisë Kulturës. Për këtë arsy, këtë vit janë planifikuar 20.000 euro të mjaftueshme për renovimin e nevojshëm. Pas intervenimit ftohet komisioni për ta vlerësuar gjendjen dhe nëse e vlerëson pozitivisht atëherë pritet pëlqimi nga ministri.

Përgjigje në pyetjen e znj. Lirije Luta: A do të organizohet mësimi joformal?

Këtë vit shkollar nuk na është lejuar nga MASHT-i organizimi i mësimit joformal.

DAK
Drejtori Z. Doda